


KOSOVA 2019: SHMANGIA E KRIZËS PASZGJEDHORE


Rrugëtimi nga certifikimi deri tek inaugurimi



Nëntor 2019

Kosova 2019: Shmangia e krizës paszgjedhore Rrugëtimi nga certifikimi deri tek inaugurimi

Me 6 tetor 2019, Kosova mbajti zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Rezultatet, të shpallura zyrtarisht më 27 nëntor, prodhuan një ndryshim të dukshëm të peisazhit politik dhe të përbërjes së Kuvendit të ri me 120 ulëse. Lëvizja Vetëvendosje i fitoi zgjedhjet, duke siguruar 29 ulëse, përderisa LDK doli e dyta, me 28



ulëse. PDK kaloi në vendin e tretë, me 24 ulëse. Partia e kryeministrit, Ramush Haradinaj, AAK (bashkë me partnerin e saj të koalicionit, PSD-në e kryetarit të Prishtinës, Shpend Ahmeti) fitoi vetëm 13 ulëse, në ndërkohë që koalicioni NISMA-AKR, i Fatmir Limajt dhe Behgjet Pacollit, mezi kaloi pragun, duke fituar 6 ulëse. Lista Serbe siguroi 10 vendet e garantuara për serbë, duke u bërë kështu partneri kyç për formimin e qeverisë. Pakicat e tjera i fituan 10 ulësë të rezervuara për to. Disa jave para certifikimit të rezultateve, Lëvizja Vetëvendosje dhe LDK, që bashkë i kanë 57 ulëse - pra katër më pak se shumica absolute, janë përfshirë në bisedime për formimin e koalicionit qeverisës.

Dy palë zgjedhjet e fundit dëshmuar se rruga nga certifikimi i rezultateve deri tek inaugurimi i Kuvendit mund të jetë e mundimshme dhe tejet e ndërlikuar. Në vitin 2014, për plotë 6 muaj Kuvendi nuk arriti të konstituohet dhe ta votonte kryetarin e vet, përderisa bllokada në vitin 2017 zgjati 88 ditë. Kësaj radhe, dy partitë fituese kanë një numër të konsiderueshëm ulësesh në kuvend, gjë që do të duhej t'iu ndihmonte në arritjen e një marrëveshjeje për formimin e qeverisë me të tjerët, vetëm me pakicat apo me to dhe me një parti tjetër shqiptare. Fakti që procesi i certifikimit u stërzgjat së tepërmi, duke marrë 52 ditë nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve, më 6 tetor, duhet të shërbejë si alarm; nuk ka më kohë për të humbur, andaj edhe rruga e mbetur procedurale duhet të përmbillet pa probleme.

Në të kaluarën, partitë politike dështuan në konstituimin e kuvendit, për shkak se armiqtë e ndërsjella e pengonin punën e shumicave parlamentare. Në vitin 2014, opozita e refuzonte kandidatin e propozuar nga partia fituese, përderisa kjo e fundit nuk ofronte asnjë opsion tjetër. Në vitin 2017, fituesi e vononte seancën, ndërkohë që opozita e bojkotonte atë. Historikisht, procesi i konstituimit të kuvendit është zhvilluar paralelisht me atë të emërimit të qeverisë, duke e kushtëzuar kështu fillimin e punës së kuvendit me arritjen e një marrëveshjeje të koalicionit. Kjo gjë bëhej e mundur për shkak edhe të vakuimit kushtetues dhe rregulloreve dhe procedurave të Kuvendit, të cilat e mundësonin një abuzim të tillë.

Është tejet e rëndësishme që skenari i vjetër të mos përsëritet më; **konstituimi i kuvendit dhe formimi i qeverisë janë dy procese të ndara.** Krijimi i të parës ndërlikohet me mandatin e drejtpërdrejtë demokratik që buron nga zgjedhjet, kështu që të gjitha partitë dhe deputetët që janë pjesë e kuvendit obligohen të jenë pjesë aktive e këtij mandati. I dyti, ndërkaq, është pasojë e zgjedhjeve dhe varet nga sigurimi i një shumice parlamentare për konstituimin e qeverisë dhe për implementimin e programit të saj, kalimin e ligjeve dhe buxhetit. Qeveritë

mund edhe të mos formohen, por kuvendi duhet gjithnjë të funksionalizohet pas zgjedhjeve. Ky artikull e shqyrton procesin e konsitutumit të kuvendit të ri dhe atë të krijimit të qeverisë së ardhshme dhe propozon kohën më optimale për arritjen e këtij synimi, pa vonesa.¹ Në të vërtetë, si afat përfundimtar për krijimin e kuvendit Kushtetuta e percakton afatin 30 ditor, pasi që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve t'i ketë certifikuar rezultatet. **Ky afat përfundimtar prej 30 ditëve është një afat absolut, i cili nuk mund të shtyhet.**

Hapi i parë gjatë përfshin presidentin, Hashim Thaçi, të cilit Kushtetuta ia kërkon që, nëpërmjet një **dekreti (1)**, të thërras mbajtjen e seancës konstitutive të kuvendit. Tradicionalisht, kjo gjë bëhet nëpërmjet konsultimeve me partitë politike që do të jenë pjesë e kuvendit, dhe ky veprim duhet të ndodh menjëherë pas certifikimit. Kuvendi mund të vendosë vetë që të thërras mbajtjen e seancës, po që se presidenti dështon në përmbushjen e këtij formaliteti, i cili mund të rrezikoj afatin përfundimtar prej 30 diteve. **Ky hap procedural duhet të përmbushet pa asnjë vonesë, në javën e parë vijuese** pas certifikimit të rezultateve.

Menjëherë pas, ish-kryetari i kuvendit, Kadri Veseli, duhet ta thërrasë një takim përgatitor (2) me përfaqësuesit e grupeve të reja parlamentare, me qëllim të përgatitjes së seancës inauguruese/konstitutive. Ky takim duhet të ndodhë të paktën 5 ditë para fillimit të seancës, në mënyrë që t'iu jepet kohë e mjaftueshme përgatitjeve. Takimi duhet të shërbejë për përcaktimin e rendit të ditës së seancës inauguruese, verifikimin e kuorumit dhe të mandateve të deputetëve të zgjedhur, si dhe për shpërndarjen e ulëseve, duke filluar nga grupi më i madh parlamentar e deri tek më i vogli. Roli i Veselit në këtë fazë është jetik për iniciimin e konsitutumit të qetë të kuvendit. Në rrethana ideale, takimi përgatitor do të duhej të mbahej menjëherë (pak ditë) pasi që presidenti të caktojë datën e seancës konstitutive. Rrjedhimisht, **ish kryetari Veseli duhet të jetë nikoqir i takimit përgatitor jo më larg se me 9 dhjetor, gjegjësisht të hënen e dytë pas certifikimit të zgjedhjeve, në mënyrë që të ndihmojë në arritjen e një tranzicioni të shpejtë dhe të qetë.**

Pastaj, **seanca inauguruese (3)** do të duhej të mbahej të hënen tjetër, gjegjësisht me 16 dhjetor, që i bie brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. E kryesuar nga deputeti më i vjetër dhe nga më i riu me moshë, kjo seancë do të shërbejë si fillim zyrtar i mandatit të VII-të të Kuvendit të Kosovës. Para fillimit të votimit, të gjithë deputetët do të betohen dhe t'i marrin edhe zyrtarisht mandatet e tyre. Po atë ditë, kuvendi do të zgjedhë kryetarin dhe 5 nënkryetarët; 3 prej të cilëve nga grupet më të medha parlamentare, dhe 2 nga partitë dhe përfaqësuesit e pakicave.² Kjo në praktikë nënkupton se Vetëvendosje do ta propozojë një kandidat për kryetar dhe një për nënkryetar të kuvendit, LDK dhe PDK do ta propozojnë nga një nënkryetar, njësoj siç do të bëjë edhe Lista Serbe dhe njëra prej partive nga radhët e pakicave joserbe.³ Në rast se ndonjëri prej kandidatëve nuk arrin ta marrë shumicën, kryetari në detyrë i kuvendit duhet të kërkojë një emër të ri nga grupi i njëjtë parlamentar, derisa të plotësohen pozitat. Gjithashtu, edhe partia që e propozon kandidatin, duhet të ofrojë kandidatë të pranueshëm për grupet e tjera në kuvend.

¹ Ky artikull përshkruan procesin e formimit të institucioneve dhe përshkak se përfshin emërimin e shumë zyrtarëve, nuk do të merret me përkatësinë gjinore të emëruarve apo zgjedhurve në këtë proces, duke nënkuptuar se flitet për poste që gra e burra do të i marrin varësisht marrëveshjeve politike.

² Kushtetuta e Kosovës, Neni 67

³ Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese e interpreton nenin 67 të Kushtetutës. Ky vendim specifikon se grupi më i madh parlamentar nënkupton subjektin ose koalicionin parazgjedhor që ka marrë pjesë në zgjedhje. Shih, Rasti Nr.KO119/14 Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. OS-V-001 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, 17 korrik 2014

Te gjitha palët duhet të kuptojnë se seanca inauguruese duhet të zhvillohet me çdo kusht, rrjedhimisht, të gjithë duhet të përmbahen nga bojkotimi ose braktisja e saj.

Zgjedhja e organeve udhëheqëse në fund të seancës inauguruese shënon edhe konstituimin ligjor të kuvendit, pas së cilës gjë mund të fillohet me themelimin e qeverisë. Prandaj, Kushtetuta edhe kërkon që presidenti Thaçi të nisë një **raund konsultimesh (4)** me partitë që janë pjesë e kuvendit. **Ky proces, që synon identifikimin e shumicës potenciale, nuk duhet të zgjas më shumë se një apo dy ditë.** Në rrethana ideale, kjo duhet të ndodhë në javën e parë të konstituimit të kuvendit. Aktgjykimi Kushtetues i korrikut 2014 e përcakton që e drejta për propozimin e kandidatit i takon grupit më të madh parlamentar – në këtë rast Vetëvendosjes.⁴ Pas kësaj, presidenti Thaçi duhet që menjëherë, gjegjësisht deri të hënën e ardhshme, më 23 dhjetor 2019, **ta nominojë kandidatin/en për kryeministër/re (5).**

Pastaj, brenda 15 ditësh nga nominimi i kandidatit të ri për kryeministër nga ana e presidentit, kryetari i Kuvendit mund ta thërras seancën parlamentare për votimin e përbërjes së qeverisë së re. Ka gjasa që **votimi për qeverinë e re (6)** të ndodhë diku në fillim të janarit 2020. Sipas Kushtetutës, kandidati duhet t'i fitojë votat e shumicës së deputetëve. Sa i përket përbërjes së kuvendit, **të gjithë akterët e tij këtë afat duhet ta marrin si një afat maksimal, dhe jo si minimal.** Po qe se kandidati për kryeministër fiton shumicën e nevojshme në kuvend (61 nga 120 vota gjithsejtë), ai ose ajo bëhet edhe zyrtarisht kryeministër/e, ndërkaq në ditët në vijim qeveria e re i merr detyrat dhe përgjegjësitë nga qeveria në largim. Qeveria e re duhet të përfshijë të paktën një ministër nga radhët e komunitetit serb dhe një tjetër nga radhët e komuniteteve tjera joshumicë.⁵ Ky i fundit nuk paraqet problem, meqenëse shumica e partive që i përfqësojnë pakicat kanë shprehur gatishmëri për bashkëpunim me partinë fituese. Por, përfaqësimi i serbëve kërkon edhe angazhimin e Listës Serbe, meqë ky koalicion është shndërruar në përfaqësuesin e vetëm të serbëve.⁶

Mirëpo, nëse **kandidati dështon (6A)** që të fitojë mbështetjen e shumicës parlamentare, sipas të njëjtës procedurë, presidenti duhet që, brenda 10 ditësh, ta nominojë një **kandidat tjetër të ri (6B)**. Në këtë rast, presidenti nuk është i obliguar të marrë parasysh vetëm partinë fituese të zgjedhjeve, duke pasur kështu më shumë hapësirë për propozimin e një kandidati tjetër koncensual nga grupi i njëjtë apo nga ndonjë grup tjetër parlamentar. Nëse edhe kandidati i dytë dështon që ta sigurojë shumicën, presidenti do të lëshojë dekretin për **shpërndarjen e kuvendit (6C)** dhe do t'i shpallë zgjedhjet e reja. **Këto zgjedhje të reja do të duhej të mbaheshin brenda 40 ditëve,** gjë që në këtë rast do të nënkuptonte fillimin e muajit mars 2020.

Thënë përgjithësisht, **në qoftë se palët i përmbahen rrjedhës së propozuar të zhvillimeve, Kosova mund të ketë një qeveri funksionale deri në gjysmën e parë të janarit 2020.** Në rastin më të keq, ndërkaq, nëse asnjëri nga kandidatët nuk arrin ta formojë qeverinë, dhe nëse palët abstenojnë nga bojkotimi i procesit, zgjedhjet e reja do të mbaheshin 150 ditë pas atyre të 6 tetorit. Mbajtja e zgjedhjeve të reja do të ishte një skenar shkatërrues për vendin.

⁴ Rasti Nr. K0103/14 përkitazi me vlerësimin e përputhjes së Nenit 84 (14) [Kompetencat e presidentit] me Nenin 95 [Zgjedhja e qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, 1 korrik 2014, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9565>

⁵ Kushtetuta e Kosovës, Neni 96 (3)

⁶ Në veçanti nëse emërimi bëhet nga jashtë kuvendit, Kushtetuta e Kosovës, Neni 96 (5)

Certifikimi i rezultateve

Më 27 nëntor 2019
Komisioni Qendror i
Zgjedhjeve bën certifikimin e
rezultateve përfundimtare



1. Dekreti mbi Seancën konstituive të Kuvendit

Presidenti i vendit e cakton datën e mbajtjes së seancës konstituive të Kuvendit të ri të Kosovës




2. Takimi përgatitor

Ish-kryetari i kuvendit (Kadri Veseli) i mbledh përfaqësuesit e partive parlamentare politike, me qëllim të përgatitjes së seancës konstituive të Kuvendit



3. Seanca konstituive e Kuvendit

Mbahet seanca konsituive, deputetët japin betimin, zgjedhin kryetarin/en dhe kryesinë 5-anëtarëshe të kuvendit.



4. Raundi i konsultimeve

Presidenti zhvillon konsultime me të gjitha partitë politike, për të përcaktuar kandidatin/en nga radhët e partisë fituese



5. Nominimi i kandidatit për kryeministër

Presidenti nominon kandidatin/en për kryeministër



7. Emërimi i Qeverisë

Qeveria konsiderohet e zgjedhur dhe fillon mandatin



6D. Shpërbërja e Kuvendit

Presidenti e shpërbën kuvendin dhe cakton datën e zgjedhjeve të reja (jo më vonë se 40 ditë)



6C. Votimi i përbërjes së qeverisë së re

Kuvendi voton për kandidatin/en e dytë (dhe për përbërjen e re të qeverisë), duke iu përmbajtur të njëjtës procedurë (brenda 10 ditësh)



6B. Raundi i ri i konsultimeve

Presidenti zhvillon një raund të ri konsultimesh me partitë politike, dhe pastaj nominon një kandidat/e të ri/e për kryeministër/e (brenda 10 ditësh)



6A. Dështimi i kandidatit

Përbërja e propozuar e qeverisë dështon të fitojë votat e deputetëve të kuvendit



6. Votimi i kandidatit/qeverisë

Kuvendi e voton qeverinë e re, të propozuar nga mandatarin/ja për kryeministër/e. Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse i merr votat e shumicës së deputetëve (zgjedhja e ministrave që përfaqësojnë komunitetet joshumicë kërkon miratimeve tyre nga shumica e deputetëve që përfaqësojnë ata)



Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (BPRG) është organizatë (Think Tank institute) e pavarur rajonale, me seli në Prishtinë, Kosovë. Ne ofrojmë analiza të detajuara të politikave zhvillimore për një sërë çështjesh të ndërlidhura me shtet-ndërtimin, konsolidimin institucional e demokratik; integrimin e minoriteteve, dhe marrëdhënieve ndërshtetërore; si dhe integrimin evropian dhe reformat politike.

Ne kemi dekada përvojë në hartim, raportim dhe zhvillim të politikave, qasje strategjike dhe avokim tek qeveritë, institucionet ndërkombëtare, si dhe organizatat joqeveritare.

Në thelbin e punës sonë qëndrojnë raportimet tona të sakta, të detajuara dhe të paanshme, gjithmonë të bazuara në hulumtimet tona nga terreni. Ne shkojmë përtej qëndrimeve të etabluara dhe synojmë të bëjmë ndryshime përmes rekomandimeve për politika për të ardhmen e që janë kreative, të realizueshme dhe të matshme, duke kontribuar që vendet tona të zhvillojnë shoqëri dhe shtete të fuqishme demokratike, të qëndrueshme dhe të suksesshme bazuar në sundimin e ligjit.

Grupi për Ballkan ka dizajnuar edhe instrumente të reja për të arritur këtë ndryshim, siç janë: Dialogu Politik, Forumi Politik (Forum për Avokim i nivelit të lartë i organizatave Think Tank) dhe Forumi i Shoqërisë Civile për Bashkëpunim Ndërkufitar.

Për më shumë, vizitoni ueb-faqen tonë www.balkansgroup.org ose, na kontaktoni në office@balkansgroup.org



Norwegian Embassy